

Salajdin SALIHU

SKËNDERBEU, SHPIRTMADHI NË VEPRIM

UDC 323.83:929Skenderbeg

Shumë herë është bërë pyetja: A do të kujtoheshin të bëmat e Magelanit nëse nuk do të ishte Pigafeta, ky kronist gjenial, që foli për itinerarin e udhëtimeve të marinarit të krisur, i cili e ndryshoi kuptimin për botën?

Mund të parashtrijmë pyetje të ngjashme: A do ta kishte këtë përmasë figura e Skënderbeut pa kronistët gjenialë: Dhimitër Frangun e Marin Barletin, të cilët e dalluan strategun që e ndryshoi historinë europiane?

Pyetjet e këtilla nuk i interesojnë historisë, e cila merret me atë që ka ndodhur, megjithatë historiani i mirë. Pyetjet e këtilla janë joshëse për letërsinë, të cilës i interesojnë edhe detajet pa të cilat zor se restaurohet imazhi i së kaluarës.

Shkrimtari interesohet edhe për luftëtarët e paemër, për klithjet e tyre derisa në mish u ngulet një heshtë, një thikë, një shtizë. Ai mendon për dhembjet që ka ndjerë ushtari i panjohur, madje edhe ushtari i palës kundërshtare; i intereson se si një hije e zezë ia ka mbuluar shikimin ushtarit; i interesojnë marramendjet e tij; se si gjymtyrët e trupit nuk i janë bindur; se si, në çastin më të pashpresë, i është shfaqur fytyra e nënës apo babait, e të dashurës apo gruas, e të birit apo të bijës; se si e ka shtrirë dorën drejt një hijeje ose ka parë diku një siluetë.

Shkrimtari shkon përtej asaj që na flasin shënimet e moçme, kronikat, pergamenat apo librat. Ai huazon nga historia për ta krijuar një realitet të përfytyruar, nëpërmjet të cilit e josh lexuesin drejt botës së tij prej gënjeshtreve, që shpalsin të vërtetat më të trishta të ekzistencës njerëzore.

Nëse historisë i intereson se Gjordano Bruno u dogj për shkak të ideve disidente, nëse filozofisë i interesojnë kategoritë morale, shkrimtari mendon edhe për klithjen e të dënuarit derisa zjarri ja digjte trupin dhe shpirtin.

Shkrimtari, kur shkruan për një kohë të largët, interesohet edhe për gjëra, në dukje të parëndësishme, për shembull: si ishte moti, si ushqeheshin njerëzit, si visheshin ata, si dashuronin dhe si luteshin, si udhëtonin dhe çfarë ëndërronin, çfarë i trishtonte dhe prej çfarë sëmundjesh vuanin apo vdisnin njerëzit e asaj kohe, si flisnin dhe çfarë fjalësh përdornin për komunikim. Shkrimtarit i intereson jo vetëm ajo që ka ndodhur, por edhe ajo që mund të kishte ndodhur ose mund të mos të kishte ndodhur...

Sipas kësaj linje të të menduari, mund të bëjmë pyetjet: A do të ishin shqiptarët të njëjtë pa Skënderbeun dhe pa epokën e tij? A do të ishin të njëjtë pa luftëtarët anonimë, që si personazhet e Zhan Rasinit, Pjer Kornejit apo si personazhet e Jeronim de Radës, i jepnin më shumë vlerë detyrës ndaj atdheut se sa pasionit individual? A do të ishin të njëjtë pa kronistët gjenialë? A do të ishin të njëjtë pa diplomatët e përmasës së Pal Ejllorit, eminencës gri të Skënderbeut?

Pasi të kemi menduar më gjatë e më thellë mund të japim këtë përgjigje: asgjë nuk do të ishte e njëjtë. Edhe Europa do të ishte ndryshe, Europa, pra, që shpesh i ka harruar shqiptarët, por nuk e harroi asnjëherë Skënderbeun. Dhe gjeniu i Europës, shpesh, përgjatë shekujve, ka pyetur: si u harrua një popull që kishte një Skënderbe?

E kujtuan Skënderbeun poetët europianë. Vazhdojnë ta kujtojnë edhe pasardhësit e atyre që pas vdekjes së tij e humbën atdheun. U kujtua Skënderbeu i pafan nga De Rada. U kujtua nga tragjiku Serembe, ashtu sikurse kujtohet sot vargu i tij gjenial: *“Arbëria matanë detit na kujton se të huaj jemi në këtë dhe”*.

Duhet thënë se qasja jonë ndaj Skënderbeut zakonisht reduktohet te veprimtari dhe përjashtohet mendimtari. Historia shqiptare është më shumë histori lufte se sa histori kulture dhe idesh. Skënderbeu si veprimtar do të ishte një figurë marginale historike. Skënderbeu si mendimtar dhe veprimtar është figurë europiane. Për këtë përmasë të kryeherit janë meritore edhe kronistët sikurse: Dhimitër Frangu, Gjon Muzaka, apo Marin Barleti. Ata i dhanë historisë shënime të çmuara, që shpesh nuk janë lexuar drejt...

Skënderbeu, si çdo figurë e madhe historike, është sulmuar dhe vazhdon të sulmohet, për shkakun se rrufetë së pari i godasin majat. Fan Noli, i cili përgjatë karrierës politike, pyeste veten se çfarë vendimi, në rastin e njëjtë, do të merrte Skënderbeu, thotë se kryeheroi kaloi nëpër tri faza: të glorifikimit, asgjësimit dhe rivlerësimit. Skënderbeu është glorifikuar, është tentuar të asgjësohet, por ai mbetet i pa rivlerësuar. Ai është mallkuar dhe vazhdon të mallkohet. Është mallkuar sa ka qenë gjallë dhe vazhdon të mallkohet edhe pas shumë shekujsh. E kanë mallkuar dhe e mallkojnë ata që i duan shqiptarët pa Skënderbe.

Po le t'u referohemi shënimeve historike. Neshri, një kronist osman i shekullit XV, shkruante se në kohërat e vjetra *“beu shqiptar Iskenderi i paguante haraç Padishahut”*, por, thotë ai, *“tundimet djallëzore ja tollovitën mendjen”* dhe pasi erdhi *“në malin Kalkandelen”* (Tetovë), u ngrit kundër Padishahut. Arnaudi Iskender, që e mori emrin nga Leka i Madh, në *“Kalkandelen”* bëri beteja të mëdha. Historia ka folur për këto beteja. E përderisa Neshri e mallkon *“arnaudin Iskender”*, që e pandehte renegat, shumë autorë europianë i thurnin himne heroit shqiptar. Pati edhe autorë që provuan t'ua *“grabitnin”* shqiptarëve Kastriotin dhe ta përvetësonin. Një tentim për ta *“grabitur”* u pengua nga Frang Bardhi. Humanisti shqiptar, derisa e shkruante Apologjinë për Skënderbeun, zotohej se do ta donte të vërtetën më shumë se sa atdheun. Ai nuk kishte përse të gënjente, sepse kronikat e moçme e kishin thënë të vërtetën për Skënderbeun. Kronikat e moçme flasin edhe për nënën e kryeherit, *“sinjoritës nga Pollogu”*, të cilës tentohet t'i mohohet përkatësia etnike.

Le të bëjmë edhe disa pyetje: Cili është historiani që mund ta dokumentojë se Skënderbeu nuk kishte origjinë shqiptare nga e ëma? Cili është dokumenti, që nuk e kemi parë, që na flet për përkatësinë joshqiptare të babait të Voisavës?

Nuk ka asnjë dokument.

Janë të paqëndrueshme konstatimet se origjina e nënës së Skënderbeut nuk mund të ishte shqiptare, sepse ishte nga Pollogu! Dokumentet flasin ndryshe: në krisobulat mesjetare arbanasit ishin banorë të Pollogut jo si popullatë shtegtare, por ndenjëtare. E pak më larg, në Ohër, mos harrojmë se qeveriste shqiptari Andrea Gropa.

Ka timare, si i Vratnicës së Tetovës, që në regjistrimet e para osmane quhej timari i Doka Gjinit ose i Dukës Gjini.

Po përse e gjithë kjo fushatë, shumë e shprehur në shekullin XIX, për mohimin e origjinës së Kastriotëve?

E thjeshtë: pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, shtetet fqinje dolën me parullën *“Ballkani ballkanasve”*, por pa shqiptarët.

Ata thanë se shqiptarët kishin luftuar përkrah osmanëve, prandaj tokat e tyre duhej të ndaheshin nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia. Por ja që Gjergji ynë ua rrëzonte këtë tezë. A nuk ishte ai luftëtari më i njohur kundër Perandorisë Osmane? E pasi ishte i tillë, atij duhej t'i mohohej origjina shqiptare. Shtetet fqinje, në prag të krijimit të shteteve kombëtare, thirreshin në vazhdimësinë shtetërore mesjetare. Ata pohonin se shqiptarët nuk kishin traditë shtetërore dhe, si të tillë, nuk mund të udhëhiqnin me shtetin e tyre. Sërish Gjergji ynë u bëhej pengesë, sepse e kishte pasur shtetin e tij. Po le të lëmë diskutet e përkohshme dhe le të shohim çfarë thotë gjeniu krijues i Europës. Është thënë se shqiptarët e krijuan mitin për Skënderbeun. Çdo figurë e madhe historike patjetër që mbështillet me veshjen e mitit. Miti për Skënderbeun nuk u krijua nga shqiptarët, por nga autorët europianë. Ata e përjasën ose e barazuan Skënderbeun me figurat mitike dhe historike të botës.

Shekulli XVI. Petrus Vincentius e quan Skënderbeun *"shpirtmadh përherë në veprim"*, që as *"Cezari i pamposhtur nuk i afrohej për trimëri të madhit të Epirit, që aq ndritshëm ngadhënjën"*. I njëjti shekull. Amadisi shkruan për Kastriotin si *"i përzgjedhur perëndish"*. Pjer Ronsardi, ky *"poet i poetëve"*, këndoi për *"të mbiquajturin Skënderbe, mbret të Shqipërisë"*, i cili ishte fat i shekullit: *"O nder i shekullit tënd! O shqiptar prej fatit sjellë!"*. Aty është i lavdishmi Edmund Spenseri. Ai e quan Skënderbeun *"të madh në emër, të madh në forcë dhe pushtet"*.

Dhe gjenitë e çdo shekulli nuk e harrojnë Skënderbeun. Shkruajnë me të njëjtin admirim Volteri, Bajroni, Longfellow.

Lufta e Skënderbeut, sikurse lufta e Trojës, "prodhoi" letërsi, prandaj, për ta studiuar *"fenomenin Skënderbe"*, duhet njëfarë *"Skënderbegologjie"*, sepse Skënderbeu nuk është vetëm fenomen historik, por edhe fenomen letrar...

Sot, kur të gjithë tentojnë ta përvetësojnë Skënderbeun, sërish shfaqen rimohuesit. Janë sinkronizuar ata që i duan shqiptarët pa Skënderbe, pa kujtimin për të. Por shqiptarët që e kanë ruajtur kujtimin për Skënderbeun, si lidhje me identitetin, do të vazhdojnë ta ruajnë sërish. E ruajtën këtë kujtim arbëreshët e Italisë, të Kroacisë, Greqisë, Sremit, Bullgarisë, Ukrainës. Shumëkush prej tyre nuk e dinin ku gjendej Arbëria, por e ndjenin në shpirt nëpërmjet emrit të Skënderbeut...

Një hero me përmasat e Kastriotit do ta donte gjithkush, por duhet ta duan ata që e kanë. Duhet ta duan edhe shqiptarët e këtyre viseve, aty ku ndodhi historia, qoftë ajo që përshkruan beteja, qoftë ajo që flet për pakte.

Le të japim një shembull: Skënderbeu shënoi dy suksese edhe në Shkup. Një në planin luftarak dhe një në planin diplomatik. Në betejën e Shkupit të vitit 1462 Skënderbeu shënoi një fitore ushtarake. Po në Shkup ai shënoi edhe një fitore diplomatike. Një vit më vonë kishte firmosur një marrëveshje me Sulltan Mehmetin II. Kjo paqe konsiderohet si veprim i mençur diplomatik, sepse Skënderbeut i duhej paqja që ta rimerrte veten, edhe pse ajo nuk ishte parë me sy të mirë nga Papa dhe Venediku...

Duke shikuar nga ky prizëm na rezulton se çdo luftë kundër Skënderbeut, kurdo qoftë, është e humbur. Është luftë kundër kujtimit të pavdekshëm. Është luftë kundër një figure të përjetësuar nga emrat më të mëdhenj të letërsisë botërore. Është luftë kundër Ronsardit, Spenserit, Volterit, Longfellowit, Bajronit. Është luftë kundër gjenitit krijues. Është luftë e përkohësisë kundër përjetësisë. Është luftë diskursesh të përkohshme kundër fjalës së përjetësuar.